ZYRA E ADMINISTRIMIT TE BASENIT UJOR SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 864 Prot.
Datë,më 15.11.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

# VENDIM

**Nr.6, datë 08.11.2022**

**PËR**

**RINOVIMIN E LEJES NR.55/2 PROT., DATË 16.10.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN NR.49, DATË 10.10.2017 "PËR PËRDORIM BURIMI UJOR KURATIV, MINERAL, TERMOMINERAL DHE GJEOTERMAL (LLIXHA), SUBJEKTIT "NDRIÇIM KUQJA"**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.55/2 prot., datë 16.10.2017 miratuar me vendimin nr.49, datë 10.10.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin për "Përdorim burimi ujor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal (llixha)" subjektit "Ndriçim Kuqja" me Adresë Njësia Administrative Tregan Elbasan Qarku Elbasan.
2. 

   Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)
   - X= 507198.6; Y= 4543126.7; Z= 257 m.m.n.d

   Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.0005 $m^3/s$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**
**LEFTER SHEHAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT UJOR - SEMAN